



Buletini Mjedisor

MESAZHI I MINISTRIT TË MJEDISIT, Z. LEFTER KOKA

Përhëndetje miq!

Sot është Dita Botërore e Mjedisit! Çdo 5 qershor, bota feston një nga ditët më të rëndësishme mjedisore të vitit. Edhe Shqipëria, si pjesë e saj, feston me një mjedis më të mirë, më të ruajtur se disa vite më parë. Në këto 4 vite, Ministria e Mjedisit ia ka dalë mbanë të sjellë në qendër të vëmendjes së opinionit publik, medias dhe shoqërisë civile, një nga komponentët më të rëndësishëm të jetës sonë - MJEDISIN.

Reformat dhe ligjet, masat dhe kontrollet, monitorimet dhe puna e përkushtuar në një hark mjaft të shkurtër kohor, kanë sjellë rezultate të padiskutueshme, të dukshme dhe të pranueshme nga të gjithë. Kjo punë e palodhur që nuk ka nevojë as të vetëlavdërohet dhe as të reklamohet, ka minimizuar katastrofën mjedisore disavjeçare që na lanë trashëgim.

Dhe rruga e nisur duhet të vazhdojë me mbështetjen e domosdoshme të çdo qytetarit! Sepse, ky është shansi ynë për të sotmen dhe të nesërmen që do të vijë! Shansi për një mjedis të mbrojtur, është shansi për të ardhmen e jetës!

5 QERSHORI -DITA BOTËRORE E MJEDISIT

Kombet e Bashkuara kanë shpallur në vitin 1972, që 5 qershori i çdo viti të njihet si Dita Botërore e Mjedisit. Çdo vit, Kombet e Bashkuara përcaktojnë një temë të caktuar për vitin, ku për vitin 2017 tema e shpallur është: "Të lidhim njerëzit me natyrën"

Duke u nisur nga kjo moto, si të afrojmë njerëzit më pranë mjedisit, Ministria e Mjedisit dhe institucionet e varësishme, veçanërisht Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, organizuan në të gjithë vendin aktivitete ndërgjegjëse, si pastrime të ambienteve rreth komunitetit ku jetojnë apo të zonave të mbrojtura pranë qytetit të tyre. Gjatë kësaj dite, në mjedis të ndryshme, u organizuan mbjellje pemësh rreth shkollave apo dhe përmirësim të bimësisë në zonat e mbrojtura, takime me komunitetet lokale etj. Të gjitha këto aktivitete kishin si qëllim parësor, të rrisin ndërgjegjësimin e komuniteteve për të treguar kujdesin e nevojshëm për mjedisin që kanë përreth.

PAK HISTORI



Më 5 qershor të vitit 1972, OKB-ja zhvilloi në Stokholm të Suedisë, konferencën e parë të mjedisit, ku u miratuan "Manifesti i Mjedisit të Njerëzimit" dhe "Plani i Veprimeve". Sipas propozimeve të konferencës së Stokholmit, në tetor të vitit 1972, Asambleja e 27-të e Përgjithshme e OKB-së vendosi të krijë "Programin e Mjedisit të OKB-së" dhe e caktoi zyrtarisht 5 qershorin, si "Ditën Botërore të Mjedisit". Nga viti 1974, Programi i Mjedisit i OKB-së cakton çdo vit, një temë për Ditën Botërore të Mjedisit, duke zhvilluar aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve për mbrojtjen e mjedisit ku jetojnë. Dita Botërore e Mjedisit, që përkujtohet më datën 5 qershor të çdo viti, është një mundësi që njerëzit në të gjithë botën të mendojnë rreth efekteve negative të shkatërrimit të mjedisit, si në nivel lokal, ashtu dhe global. Ka shumë çështje ndërkombëtare të mjedisit që kanë nevojë për vëmendje urgjente, të tilla si: Ndryshimet Klimatike, Biodiversiteti, Siguria Mjedisore, të cilat ndikojnë në shëndetin e planetit tonë, popullsisë, florës dhe faunës.

CILËSIA E UJËRAVE TË PLAZHEVE TONA PËR VITIN 2017



7 Qershor 2017– Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, z. Julian Beqiri, publikoi gjatë një konference për shtyp, të dhënat e monitorimit paraprak të cilësisë së ujërave larës përgjatë vijës bregdetare për vitin 2017.

Nga monitorimet e kryera gjatë muajit maj 2017, rezultoni se këtë vit plazhet shqiptare janë të një cilësie shumë të mirë.

"Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka bërë një monitorim kampionimi në 102 pika, përgjatë vijës bregdetare dhe ka realizuar monitorimin e ujërave larës në 20 plazhe.

Nga analizat rezultoni cilësi shumë e mirë në rreth 99 pika monitorimi, pra mund të themi që plazhi mirëpret me një cilësi shumë të mirë uji të gjithë pushuesit", u shpreh z. Beqiri.

Duke u ndalur në rezultatet e monitorimit të parë të këtij viti, kreu i AKM-së theksoi se, ndërsa kemi një cilësi shumë të mirë të ujërave larës, pastërtia e rërës lë shumë për të dëshiruar. "Gjatë monitorimit kemi vënë re se

kemi problematika, për sa i përket cilësisë së rërës. Mungojnë koshat për hedhjen e mbeturinave, mungon informacioni që mund t'u jepet nga pushteti lokal pushuesve me tabela, ku të jepen të dhëna për cilësinë e plazheve, pasi është mirë që informacioni të ndahet me qytetarët. Pushteti lokal është ende shumë larg punës që duhet të bëjë, për administrimin si duhet të plazheve", tha z. Beqiri.

Në bazë të rezultateve të fazës paraprake të cilësisë së ujërave larës për vitin 2017, rezultoni se:

- Cilësia e ujërave larës është shumë e mirë në plazhet e Divjakës, Velipojës, Tales, Shëngjinit, Gjirit të Lalzës, Golemit, Qerretit, Spillesë, Orikutit, Zvërnecit, Vlorës, Dhërmiut, Himarës, Qeparoit, Borshit, Ksamilit, Sarandës, Semanit, Durrësit dhe Palasës.

- Cilësia e ujërave larës është e mirë në 3 pika monitorimi, të "Shkolla e Marinës" në Vlorë, të Kanalit i Çukës në Sarandë dhe të kompleksi "Giardino" në Durrës. Vlen të theksohet se këto pika 3 pika një vit më parë, kanë rezultuar

me cilësi të keqe të ujërave.

- Cilësia e ujërave larës është përkëqësuar në 2 pika të plazhit të Durrësit, konkretisht në plazhin "Zhiron" dhe pas kanalit të Plepat, ku në bazë të analizave të kampioneve të marra, ujërat larës kanë rezultuar me një cilësi të keqe. Monitorimi paraprak i AKM-së, për vitin 2017, është shtrirë në 102 pika, nga 99 pika në vitin 2016 dhe 78 pika në vitin 2015, duke rritur në këtë mënyrë monitorimin gjatë gjithë vijës bregdetare. Në listën e plazheve të monitoruara për herë të parë, është shtuar edhe plazhi i Palasës me dy pika, të cilat kanë rezultuar të një cilësie shumë të mirë.

Të dhënat e fazës së parë të monitorimit të ujërave larës për këtë vit, janë të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit eeea.akm.gov.al, ku çdo qytetar mund të gjejë informacionin për plazhet, krahasuar edhe me rezultatet e vitit 2016.



NË KËTË NUMËR:

5 QERSHORI -DITA BOTËRORE E MJEDISIT, FQ 1

RRUGËTIMI I PROJEKTIT BIOLITZ GJATË KËTËJ VITI SHKOLLOR, FQ 2

FONDI I GJELHËR I KILMËS MIRESHI SI VENDET E KALONIT TË ENDPËS LONDRE DHE AZHË QËNDRORE, FQ 3

AKTIVITETE NGA SHOQATAT MJEDISORE, FQ 4

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmes kësaj misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitje dhe bashkëpunim veprimtarë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".

DITA E LIQENEVE



Muaji qershor mund të quhet ndryshe edhe muaji i Liqeneve, pasi në këtë muaj është Dita e Liqenit të Shkodrës dhe Dita e Liqenit të

Ohrit.

Që nga viti 2005, 4 qershori i çdo viti është shpallur nga Ministria e Mjedisit të Shqipërisë dhe ajo e Malit të Zi, si Dita e Liqenit të Shkodrës. Si çdo vit, edhe në 2017, Ministria e Mjedisit dhe bashkia e Shkodrës organizuan aktivitete sensibilizuese për Liqenin. Ky aktivitet u mundësua nga forumi shqiptar "Liqeni i Shkodrës", i cili organizoi eventin promovues: "Dedikim vlerave të ekosistemit", aktivitet i mundësuar nga kontributi dhe përkushtimi i rinisë shkodrane.

Në këtë aktivitet morrte pjesë dhe zëvendësministri i Mjedisit, z.

Kledi Xhaxhiu, i cili në fjalën e tij të përshëndetjes informoi se së shpejti, do të fillojë dhe një projekt që do të mundësojë lidhjen e urës së Bunës me pikën kufitare të Malit të Zi, përmes liqenit të Shkodrës. Ky investim në urbanistikë, pritet të fillojë në javët në vazhdim. Nga ana tjetër, kryebashkiakja e Shkodrës, zj. Voltana Ademi, po pjesëmarrëse në takim, theksoi se mbetej sfida për bashkinë Shkodër, krijimi i impantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Shkodrës.



21 Qershori është dhe Dita e Liqenit të

Ohrit. Për herë të parë Dita e Liqenit të

Ohrit është përkujtuar në vitin 2002,

me qëllim rritjen e vëmendjes qoftë të

qytetarëve, qoftë të autoriteteve lokale për mbrojtjen e pasurisë

natyrore dhe kulturore të rajonit, si dhe përafrimin e mëtejshëm të banorëve në të dyja anët e liqenit.

Në këtë ditë, nxënësit e shkollës së mesme "Muharrem Çollaku", të mbështetur dhe nga Administrata e Zonave të Mbrojtura të Korçës, bënë promovimin e vlerave natyrore të kësaj zone të mbrojtur. Nga AdZM-ja, për të pranishmit, u shpërndanë fletëpalosje, broshura, harta të ZM-së dhe informacioni i nevojshëm sipas tematikës që kërkohet.

Në çdo vit Dita e Liqenit festohet nga disa bashki të cilat lagen nga liqeni, por mesazhi është gjithmonë i njëjtë: ngritja e vetëdijes së opinionit për bashkëpunim sa më të madh të qytetarëve dhe të pushtetit për mbrojtjen e basenit të liqenit të Ohrit, si pasuri e pazëvendësueshme natyrore.



BRUGËTIMI I PROJEKTIT BIOBLITZ GJATË KËTJË VITI SHKOLLOR



Prej më shumë se një viti shkollor, Ministria e Mjedisit dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim kanë bashkëpunuar për të zbatuar projektin BioBlitz Albania, në 23

shkolla nëntëvjeçare në të gjithë vendin.

Në zbatim të Programit Kombëtar për Edukim Mjedisor 2015 – 2017, një dokument strategjik i miratuar nga ministri i Mjedisit dhe ministri i Arsimit në shkurt të 2015, Ministria e Mjedisit, me mbështetjen bujare të projektit të PNUD-it, "EIMMS" – Për ngritjen e sistemit të menaxhimit të informacionit mjedisor - kanë ndërmarrë gjatë 12 muajve të fundit, një fushatë intensive të përfshirjes së nxënësve të klasave të nënta në të gjithë vendin në aktivitete të ndryshme mjedisore, duke i vënë theksin larmisë biologjike në vendin tonë, rolin të qytetarit në mbrojtje të mjedisit dhe biodiversitetit, si dhe vetë kontributit qytetar në promovimin e shkencës apo asaj që njihet si "shkenca e qytetarëve" posaçërisht, përmes krijimit të një inventari të florës dhe faunës së vendit, të bërë nga vetë nxënësit dhe shoqëria civile.

Po çfarë është një BioBlitz? Në aktivitetin BioBlitz, qytetarët/nxënësit

ndihmojnë për të identifikuar sa më shumë specie që të jetë e mundur në zonën e tyre natyrore.



Përmes kësaj veprimtarie, nxënësit mësojnë si të përdorin harta dhe përfaqësime të tjera gjeografike, teknologji gjeohapësinore dhe të menduarit hapësinor, për të kuptuar dhe komunikuar informacionet që lidhen me mjedisin. Përmes iniciativës njëvjeçare të Bioblitz Shqipëri, ne arritëm të krijonim një inventar të florës



dhe faunës të bërë nga shoqëria civile dhe angazhimi i nxënësve që ishte (i) miqësor, (ii) transparent, (iii) me kosto të ulët, (iv) gjithëpërfshirës (v) dhe solli një ndikim të drejtpërdrejtë në programet e arsimit për edukimin mjedisor.

Në projektin Bioblitz Shqipëri u përfshinë 23 shkolla nëntëvjeçare në të gjithë vendin, me rreth 600 nxënësit të klasave të nënta: "Riza Spahiu" Kukës, "Gjergj Fishta" Lezhë, "Adem Gjeli" Fushë - Krujë, "Shaqe Mazreku" Durrës, "Ismail Qemali" Shkodër, "Kongresi i Lushnjës" Lushnjë, "Jani Minga" Vlorë, "Sami Frashëri" dhe Tirana International School (TIS) Tiranë, "22 Tetori" Berat, "Mustafa Gjestila" Burrel, "Mark Dashi" Fier, "Rilindja" Kavajë, "Abdyl Paralloi" Elbasan, "Pjetër Arbnoçi" Fushë-Arrës, shkolla 9-vjeçare Rubik, "Nonda Bulka" Përmet, "Mësonjëtorja e parë" Korçë, "Gjokë Shqiptari" Pogradec, "Papa Kristo Negovani" Ersekë, "Andon Zako Çajupi" dhe "Naim Frashëri" Gjirokastrë; "Ali Podrimja" Bajram Curri.

Në këtë program, përmes portalit dhe aplikacionit "iNaturalist3", nxënësit në të gjithë vendin, iu bashkuan kësaj nisme, duke e çuar numrin e vëzhgimeve në natyrë në 1550 fotografime dhe gjeoreferime të llojeve të ndryshme të florës dhe faunës, të cilat krijuan për herë të parë një Katalog të Florës dhe Faunës të kryer nga nxënësit e shkollave dhe qytetarë të tjerë.

Përveç pjesës së vëzhgimit në natyrë, nxënësit ndoqën edhe modulën mësimor në klasë, ku u përfshinë tema, si: rëndësia e edukimit mjedisor, Konventa e Aarhusit dhe të drejtat qytetare në lidhje me mjedisin dhe vendimmarrjen mjedisore; biodiversiteti në vendin tonë dhe biodiversiteti i zonës përkatëse; rrjeti i

Zonave të Mbrojtura, problematikat mjedisore të qytetit apo rajonit të tyre.



Përmes kësaj projekti, shkollave iu dhuruan pajisje të ndryshme për laboratorët e biologjisë, si: mikroskop, lupa zmadhuese, etiketa, kavanoza qelqi, rrjeta për flutura, kanavaca të bardha,

lama, lamela dhe materiale të tjera laboratorike.

Ky projekt ishte një mundësi e mirë për të gjithë aktorët e përfshirë, për të risjellë në vëmendje jo vetëm faktin se edukimi mjedisor është shumë më tepër se informim mjedisor, por për të na kujtuar se roli dhe kontributi i qytetarit nuk është thjesht të mbrojtë mjedisin, por edhe të kontribuojë në përparimin e shkencës, si pjesë e edukimit mjedisor.

AKTIVITETET E BIOBLITZ GJATË MUAJIT QERSHOR



Ekipi i Ministrisë së Mjedisit dhe projekti BioBlitz Albania vijuan orët e fundit mjedisore për vitin shkollor 2017, me nxënësit e shkollave nëntëvjeçare të shkollës Tirana International School - (TIS). Kjo shkollë kishte shprehur interesin për të njohur nxënësit e tyre me projektin Bioblitz Shqipëria.

Gjithashtu, në ditën e fundit të shkollës, ekipi i Ministrisë së Mjedisit dhe projekti BioBlitz Albania ishin me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare "Papa Kristo Negovani", në qytetin e Ersekës, ku biseda për mjedisin dhe rëndësinë e mbrojtjes së tij u pasua nga festimet dhe veprimtaritë sportive.



AMBASADORI ITALIAN NË PARKUN KOMBËTAR DETAR TË KARABURUN - SAZANIT



16 Qershor 2017 - Ambasadori i Italisë, z. Alberto Cutillo, vizitoi Parkun Kombëtar Detar "Karaburun - Sazan". Ai shoqërohej nga drejtori i AICS-it z. Nino Merola, përfaqësues të UNDP-së Albania, stafi i projektit NaturAl dhe AKZM-ja/AdZM-ja



Vlorë. Gjatë takimit të pranishmit vizituan Qendrën e Informacionit në Radhimë, më pas ata bënë një vizitë në ishullin e Sazanit, në monumentin e natyrës "Shpella e Haxhi Alisë". Gjatë vizitave në

këtë zonë ata diskutuan dhe për nevojën e investimeve në parkun e parë detar me qëllim funksionimin dhe menaxhimin më të mirë të tij.





Më 7 qershor 2017 u nënshkrua një marrëveshje partneriteti për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të sistemit shqiptar të Zonave të Mbrojtura. Në këtë nënshkrim mermin pjesë Drejtori Ekzekutiv i REC-it, z. Mihal Dimovski, përfaqësuesi i PNUD-it Shqipëri, z. Brian J. Williams dhe Drejtori i Kabinetit të Ministrisë të Mjedisit, z. Argent Alltari.

Për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të sistemit shqiptar të zonave të mbrojtura, është duke u zhvilluar tashmë një projekt i ri, i cili është hartuar për të ndihmuar qeverinë shqiptare në zvogëlimin e mangësive ekzistuese të financimit për këto zona, përmirësimin e menaxhimit të tyre, zbatimin e efikas të kostos për Zonat e Mbrojtura individuale dhe zhvillimin e kapaciteteve të menaxhimit financiar të stafit të AKZM-ve. Shqipëria ka krijuar një sistem përfaqësues të Zonave të Mbrojtura (ZM), që mbulon pothuajse 16 për qind të territorit

shqiptar. Sistemi i ZM-ve përbëhet kryesisht nga 15 parqe kombëtare, disa rezerva natyrore të menaxhuara dhe peizazhe të mbrojtura, që strehojnë vlerat më të mëdha natyrore dhe biodiversitetit të vendit. Një plotësues i kohëve të fundit për këtë rrjet të madh është një grup i Zonave të Mbrojtura Rajonale (ZMR), të cilat administrohen nga autoritetet vendore.

Gjatë 20 viteve të fundit, Zonat e Mbrojtura në Shqipëri nuk janë integruar në politikat kombëtare dhe vendore të zhvillimit, në mënyrë që mund t'i bëjnë ato të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe rajonal. Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM), e themeluar kohët e fundit, po punon në mënyrë aktive për të përmirësuar administrimin e Zonave të Mbrojtura, sipas kërkesave, standardeve ndërkombëtare dhe përvojës së vendeve të tjera evropiane, të cilat do të kontribuojnë si në përmirësimin e ruajtjes së natyrës dhe përdorimit e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për më tepër, Parlamenti

Shqiptar miratoi një ligj të ri për Zonat e Mbrojtura vetëm disa muaj më parë. Projekti katërvjeçar do të zbatohet nga UNDP-ja Shqipëri, REC-u dhe AKZM-ja, deri në vitin 2020. Projekti ka dy shtylla kryesore: të rrisë kapacitetet e menaxhimit financiar të agjencisë përgjegjëse për administrimin e sistemit të Zonave të Mbrojtura; të demonstrojë efikasitetin e strategjive të ndryshme të financimit brenda një nëngrupi të Zonave të Mbrojtura individuale. Zonat e synuara pilote do të jenë tre parqe kombëtare:

- Parku Kombëtar i Dajtit - vlerësimi i fizibilitetit të flukseve financiare nga ndërmarrjet tregtare;
- Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta - vlerësimi i qëndrueshmërisë së aktiviteteve, të tilla si: peshkimi, bujqësia dhe pylltaria;
- Kompleksi Llogara-Karaburun - vlerësimi i mekanizmeve për mbledhjen e të ardhurave nga fluksi i vizitorëve rekreativë gjatë verës.

FONDI I GJELBËR I KLIMËS Mbledh 13 VENDET E RAJONIT TË EVROPËS LINDORE DHE AZISË QËNDRORE



Nga data 31 maj deri në 2 qershor 2017, në Tbilisi të Gjeorgjisë, u zhvillua takimi i parë i Fondit të Gjelbër të Klimës për vendet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore (EECA). Ky takim bashkoi rreth tij shumë aktorë me qëllimin e vetëm për të kuptuar më mirë angazhimin e këtij rajoni me Fondin e Gjelbër të Klimës.

Si takimi i parë rajonal i organizuar nga ky Fond për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, ky takim tregoi synoi rritjen e të kuptuarit dhe të procedurave të modaliteteve nga pjesëmarrësit, identifikimin e projekteve prioritare në partneritet me Entitetet e Akredituara dhe sigurimin e një platforme për të shkëmbyer eksperiencën për të gjitha aspektet kryesore të Fondit.

Ky takim rajonal, i financuar nga Fondi i Gjelbër i Klimës dhe mbështetur nga Qeveria e Republikës së Gjeorgjisë, kishte si objektiv të rriste njohuritë e përfaqësuesve të vendeve të rajonit të Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore, për të kuptuar më mirë se si funksionon ky Fond, si edhe mekanizmat e ndryshëm të financimit dhe të mbështetjes, që tashmë janë vënë në dispozicion.

Sesionet e zhvilluara mbuluan një varg temash me qëllim ndihmesën e vendeve për prekjen e burimeve të Fondit. Në fokus ishin rolet dhe përgjegjësitë e Autoriteteve Kombëtare të Nominuara (NDA), proceset që lidhen me akreditimin dhe dorëzimin e propozimeve të financimit, si dhe Programin e Gatishmërisë së Fondit dhe Njësive të Përgatitjes së Projekteve. Pjesëmarrësit patën mundësi për të mësuar rreth rolit të sektorit privat, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesit, për

mbështetjen e përpjekjeve të tyre ndaj Ndryshimeve Klimatike.

Takimi u përshëndet nëpërmjet një videokonferencë nga Drejtori Ekzekutiv i Fondit të Gjelbër të Klimës, z. Howard Bamsey, i cili mes të tjerave tha se: "Ky është një takim i rëndësishëm, sepse është hera e parë që është punuar me vendet e rajonit në këtë format. Ky takim do të mundësojë që Fondi të dëgjojë nga afër interesat dhe shqetësimet e vendeve, dhe të ndihmojë në ecjen përpara të aspiratave të këtij rajoni, për të ndërmarrë veprime ndaj Ndryshimeve Klimatike". Gjithashtu në fjalën e tij z. Bamsey vuri në dukje se Fondi do të ndihmojë në nxitjen e veprimeve ndaj Ndryshimeve Klimatike në rajonin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore, për të ndihmuar vendet të kenë një mundësi përfitimë nga fondit që FGJK-ja ka në dispozicion, për të mbështetur arritjet dhe kontributet e përcaktuara në nivel kombëtar, sipas Marrëveshjes së Parisit për Ndryshimet Klimatike.

Më pas në fjalën e tij, z. Andrej Lakiq, nga Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit nga Mali i Zi, theksoi se: "Gjatë viteve të fundit, vendet e Ballkanit kanë përjetuar një seri katastrofash natyrore që kanë të bëjnë me Ndryshimet Klimatike, duke përfshirë këtu edhe përmbytje serioze. Kjo ka përforeuar nevojën për të marrë masa me karakter adaptues. Meqenëse vendet e Malit të Zi, Serbisë, Bosnjes, Maqedonisë dhe Shqipërisë hasin probleme të ngjashme, do të ishte e dobishme të punohet më ngushtë së bashku". "Mbështetja e hershme e FGJK-së do të ishte e dobishme, pasi sektori privat në këtë pjesë të botës nuk është mësuar me shumë nga kërkesat për të pasur akses në fondet e FGJK-së, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe mbrojtjen e mjedisit", shtoi ai.

Shumë nga pjesëmarrësit në seminar ishin të interesuar të dëgjonin se si FGJK-ja mund të ofrojë mbështetje për vendet që planifikojnë të dorëzojnë propozime për financim në Fond.

Në këtë takim morën pjesë rreth 70 pjesëmarrës, ku përfshiheshin delegacione nga 13 vende, përfaqësues nga tetë Entitete të Akredituara të FGJK-së, 10 subjekte kombëtare të emëruara të Qendrës për Teknologji dhe Rrjete Klimatike, si dhe disa institucione vëzhguese nga shoqëria civile dhe sektori privat.

Fondi i Gjelbër i Klimës (FGJK) është një fond i themeluar në kuadrin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), për të ndihmuar vendet në zhvillim, në praktikën e adaptimit dhe zbutjes, për t'u përballur me ndryshimet klimatike. Selia e Fondit të Gjelbër të Klimës ndodhet në Korenë e Jugut dhe qeveriset nga një bord prej 24 anëtarësh.

Marrëveshja e Kopenhagenit, e krijuar gjatë Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike të vitit 2009 (COP-15) në Kopenhagen, përmend për herë të parë Fondin e Gjelbër të Klimës.

Fondi u krijua zyrtarisht gjatë Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në vitin 2010 në Kankun, si një fond brenda kornizës së KKKBNK-së.

Qëllimi i Fondit të Gjelbër të Klimës është mbështetja e projekteve, programeve, politikave dhe aktiviteteve të tjera në vendet në zhvillim që përdorin këtë financim. Është menduar që Fondi i Gjelbër i Klimës të jetë thelbi i përpjekjeve për të rritur Financimet e Klimës në kuadrin të KKKBNK-së, deri në 100 miliardë dollarë deri në vitin 2020.


8 QERSHORI –DITA NDËRKOMBËTARE E OQEANAVE

Dita Ndërkombëtare e Oqeanit është deklaruar nga Kombet e Bashkuara, data 8 qershor e çdo viti, duke filluar nga viti 2009. Kjo ditë i shërben njerëzimit të sensibilizohet për rëndësinë e një mjedisi të pastër detar, si një habitat shumë i rëndësishëm për gjallesat nënujore, si një mjedis argëtues dhe kurues për popullsinë dhe si një burim ushqimi me një peshë të madhe në jetesën tonë. Kjo ditë shërben për të ndërgjigësuar njerëzimin

se moskujdesi për ujërat e oqeanave dhe deteve sjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasoja të parikupërueshme në shëndet. Më 8 qershor, përkujtohen oqeanet për të forcuar lidhjen tonë personale me detin dhe hapësirën e madhe blu që mbulon mbi 70 % të globit. Oqeanet dhe detet janë faktorët kryesorë të jetës sonë në këtë planet. Kjo datë është gjithashtu një mundësi për të reflektuar "shëndetin" e oqeanit dhe gjallesave të mrekullueshme

që jetojnë në të.

Shqipëria, edhe pse nuk ka oqean, laget nga dy dete, për të cilat pa dyshim duhet të rrisë ndërgjegjësimin e autoriteteve në nivel lokal dhe qendror, për të ndërmarrë politikat e duhura për të mbrojtur dhe mbajtur pastër këto burime natyrore.



PARKU KOMBËTAR "SHEBENIK-JABLLANICË", është pjesë e një zone të gjerë dhe komplekse gjeografike. Ky park është një zonë me bukuri të rralla natyrore, ku gjenden disa nga peizazhet malore më madhështore dhe më befasese në tërë Ballkanin. Ai shtrihet përgjatë luginës së lumit Shkumbin, në lartësinë 2260 m mbi nivelin e detit. Parku është habitat i arnui të marmmë, ujkut, dhisë së egër, derrit të egër etj. Në ujërat e ftohta rritet trofta e kuqerremtë. Zona dallohet për florën e pasur dhe shumë të larmishme, prej kushteve të përshtatshme të terrenit dhe formave të tyre të shumta gjeologjike e gjeografike.


SEKTORI I TRANSPARENÇES DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

AKTIVITETE NGA SHOQATAT MJEDISORE



PPNEA PROJEKT PËR RUAJTJEN E RRËQEBULLIT

Mali i Munellës, si pjesë e rajonit Pukë-Mirditë, është një zonë e rëndësishme me vlera të larta natyrore dhe strehë e faunës së egër, midis tyre edhe e specisë së rrezikuar në mënyrë kritike, Rrëqebullit të Ballkanit. Në kuadër të "Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit", PPNEA ka organizuar aktivitete të ndryshme në këtë zonë, me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të çmuara natyrore dhe veçanërisht të Rrëqebullit të Ballkanit. Veç kësaj, PPNEA po realizon në këtë rajon, një proces të gjerë konsultimi me aktorë të ndryshëm të zonës, me qëllim shpalljen e Malit të Munellës si zonë e mbrojtur. Arren, Surroj dhe Lumzi ishin tri njësitë administrative të radhës, që ekipi i PPNEA -s vizitoi në kuadër të këtij procesi konsultimi. Takimet në këto njësi administrative kishin si qëllim prezantimin e nismës të ndërmarrë nga kjo shoqatë. Ata shpjeguan se si do të ndikonte shpallja e Munellës si zonë e mbrojtur, për banorët e zonës përreth. Në të tre takimet e realizuara morën pjesë përfaqësues të qeverisjes vendore, fermerë, biznesmenë dhe të interesuar të tjerë.



së fundmi nga Shoqëria e Ornitologëve të Shqipërisë shohim se gjatë këtij muaji është ndërmarrë prej tyre një ekspeditë eksploruese për të vrojtuar shpendët ujorë që gjenden në lumin Vjosa. AOS-i së bashku me kolegë slovenë eksploran në detaje shpendët e lumit dhe të luginës së Vjosës. Vrojtimet në se 14 orë (5.00 - 21.00), përfshijnë shtratin e lumit dhe rrjedhat që e furnizojnë atë. Ky grup ekspertësh kombinoi shikimin, dëgjimin, unazimin, edukimin mbi metodat e studimit të shpendëve, por edhe filmimet për një dokumentar mbi domosdoshmërinë e ruajtjes së këtij ekosistemi të paprekur nga digat e hidrocentraleve. Tashmë Vjosa nuk është thjesht një lumë për ta, por është padyshim një vend magjepsës, një shtrat lumor fort i pasur, ku u vrojtuan rreth 120 lloje shpendësh. Të gjitha këto lloje në vetëm një mjedis ujor, vazhdojnë të surprizojnë këdo që njihet me pasurinë e tij të jashtëzakonshme. Kjo është dhe një arsye më shumë për ta lënë këtë lumë me pasuri të rralla, jashtë industrializimit të segmenteve të saj.



AOS-I EKSPLORON SHPENDËT E LUGINËS SË LUMIT TË VJOSËS



Nga publikimet e bëra



REC-U TRAJNON SHOQATAT PËR INFORMACIONIN MJEDISOR
Qendra Rajonale e Mjedisit REC Shqipëri, në kuadër të

programit "Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENIOR-II)", mbështetur nga Qeveria e Suedisë (SWEDEN), si pjesë e Paketës së Trajnimeve për Menaxhimin Mjedisor, organizoi trajnimin tematik "Menaxhimi i Informacionit Mjedisor – institucionet përgjegjëse dhe monitorimi i të dhënave". Qëllimi i këtij trajnimi ishte: (i) rritja e aftësive në fushën e menaxhimit të informacionit mjedisor; (ii) njohja me institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe grumbullimin e të dhënave mjedisore; (iii) përpunimi dhe publikimi i të dhënave, bazuar dhe në teknologjitë më të fundit të informacionit; mënyrat/metodat e duhura për raportimin dhe përcimin e informacionit mjedisor të publiku. Në këtë trajnim, përfaqësues të ndryshëm nga institucionet që janë krijuar dhe posedues të informacionit mjedisor iu shpjeguan përfaqësuesve të organizatave, kryesisht të reja, se ku gjendet informacioni mjedisor, mënyra se si mund të kërkohet ai, progresi i bërë vitet e fundit, si dhe problematika e hasur gjatë procesit të informimit. Ekspertët e përzgjedhur nga REC –u ishin përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përfaqësuesit që merren me të dhënat e mjedisit në IN-STAT etj.

E RRALLË, NË GJIRIN E VLORËS KAPET BRESHKA FLUTURUESE



Një specie e rrallë për ujërat tona është gjetur në afërsi të Orikumit në Gjirin e Vlorës, pranë

Pashalimanit.

Bëhet fjalë për një specie që quhet breshka fluturuese, për shkak të shpejtësisë që lëviz në ujë dhe faktin që ka krahë që ngjasojnë si flatra.

Breshka fluturuese është e rrallë për ujërat tona, ndërsa cilësohet një specie ne zhdukje. Për këtë qëllim është bërë matkulimi i saj nga biologët dhe është lëshuar sërish në det.

Profesor Idriz Haxhiu, biolog, tha se në 20 vite janë tri specie të tilla të gjetura në detin Adriatik dhe Jon. Breshka është 20 vjeçe dhe peshon rreth 10 kilogram.

Sipas biologëve breshka "Chelonia mydas", që është emri i këtyre breshkave barngrënese, mund të jetojnë deri në 100 vite dhe të arrijnë deri në 500 kilogram.